



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Shkencave të Edukimit**

**Me datë: 18.07.2022**

1	Hava Istogu	Efektet e edukimit gjithëpërfshirës në performancën akademike dhe zhvillimin socio-emocional të fëmijëve me zhvillim tipik	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Blerta Perolli	
			Anetar/e	Albulena Metaj	
2	Granit Nrecaj	Aplikimi i punës në grupe nga mësime ndihmëse dhe ndikimi i kësaj forme në aftësitë bashkëpunuese të nxënësve	Kryetar/e	Majlinda Gjellaj	Miratohet
			Mentor/e	Vjollca Ahmedi	
			Anetar/e	Atdhe Hykolli	
3	Mirlinda Jasiqi	Qëndrimet e mësime ndihmëse rreth standardeve të zhvillimit profesional në arsimin parauniversitar në Kosovë	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
4	Donika Behluli	Përparësitë e zbatimit të teknikave ndërvepruese në klasat gjithëpërfshirëse	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Januz Dervodeli	

## **HAVA ISTOGU**

**Tema: Efektet e edukimit gjithëpërfshirës në performancën akademike dhe zhvillimin socio-emocional të fëmijëve me zhvillim tipik**

**Komisioni:**

**Prof.asoc. Naser Zabeli, kryetar**

**Prof.ass. Blerta Perolli Shehu, mentor**

**Prof.ass. Albulena Metaj, anëtar**

## **ABSTRAKTI**

Edukimi gjithëpërfshirës është arsimimi i nxënësve me zhvillim atipik së bashku me nxënësit me zhvillim tipik në një klasë. Ka shumë hulumtime mbi efektet e gjithëpërfshirjes për fëmijët me zhvillim atipik, megjithatë jo edhe për fëmijët me zhvillim tipik në mjediset gjithëpërfshirëse. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi është të studiojë efektet e gjithëpërfshirjes në performancën akademike dhe socio-emocionale të fëmijët me zhvillim tipik, duke përfshirë edhe pjesën e qëndrimeve të nxënësve me zhvillim tipik ndaj nxënësve me zhvillim atipik sipas këndvështrimit të mësimdhënësve. Ky hulumtim tenton të qartësoj ndikimin e edukimit gjithëpërfshirës në performancën akademike dhe socio-emocionale të fëmijët me zhvillim tipik duke hipotetizuar se të mësuarit gjithëpërfshirës i fëmijëve me zhvillim atipik dhe atyre tipik ndikon në performancë me të lartë akademike të këta të fundit, në sjellje sociale më pozitive të fëmijëve me zhvillim tipik kundrejt personave me zhvillim atipik si dhe në qëndrime më pozitive të fëmijëve me zhvillim tipik ndaj atyre me zhvillim atipik. Ky studim do të udhëhiqet nga pyetjet hulumtuese përmes të cilave do dimë sa ndërlihet edukimi gjithëpërfshirës me performancën akademike, sjelljen sociale dhe qëndrimet e nxënësve me zhvillim tipik ndaj nxënësve me zhvillim atipik.

Metodologjia e hulumtimit për këtë studim është metoda mikse (sasiore dhe cilësore). Instrumenti matës për mbledhjen e të dhënave është përpiluar në formë të pyetësorit me pyetje të mbyllura dhe të hapura, i cili është realizuar me një mostër prej 120 mësimdhënës të shkollave fillore (mësimdhënës të ciklit fillor I-V) në komunën e Prishtinës, Drenasit dhe Skënderajit. Sipas rezultateve të hulumtimit nxënësit me zhvillim tipik përfitojnë më shumë si në performancën akademike ashtu edhe në aspektin socio-emocional nga të qenit në klasa gjithëpërfshirëse me nxënës me zhvillim atipik. Ky hulumtim pritet të ndihmojnë mësimdhënësit në praktikën shkollore që të ngrisin vetëdijen e tyre rreth gjithëpërfshirjes dhe ndikimit që mund të ketë gjithëpërfshirja tek nxënësit me zhvillim tipik.

**Fjalët kyçe:** *performancë akademike, fëmijë me zhvillim tipik, gjithëpërfshirje, zhvillim socio-emocional*

**DONIKA BEHLULI**

**Tema: Përparësitë e zbatimit të teknikave ndërvepruese në klasat gjithëpërfshirëse**

**Komisioni:**

**Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor**

**Prof. Ass. Ardita Devolli, kryetare**

**Prof. Asoc. Januz Dërvodeli, anëtar**

### **ABSTRAKTI**

Ky punim është hulumtim përfaqësor, i cili ka pasur për qëllim të hulumtojë përparësitë e zbatimit të teknikave ndërvepruese në klasat gjithëpërfshirëse. Për realizimin e këtij hulumtimi janë mbledhur të dhëna sasiore, që do të thotë se hulumtimi është kuantitativ. Përmes këtij hulumtimi do t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve: 1. Cilat janë përparësitë e zbatimit të teknikave ndërvepruese në klasat gjithëpërfshirëse në institucionet arsimore të Kosovës?; 2. A ka dallim përgatitja profesionale e stafit arsimorë bachelor –master në performancë punë?

Mostër për këtë hulumtim kemi përfshirë gjithsej 150 mësimdhënës në rajonin e Pejës. Nga 150 mësimdhënës të anketuar, 23 mësimdhënës/e të anketuar ishin nga komuna e Istogut, 25 nga komuna e Klinës dhe 102 ishin nga komuna e Pejës. Instrument për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur pyetësorin, i cili është hartuar enkas për këtë hulumtim. Pyetësori përmban gjithsej 6 pyetje demografike, si dhe 12 pyetje hulumtuese të lidhura me temën e trajtuar në këtë punim. Nga këto 12 pyetje, vetëm një ishte pyetje e hapur, tjerat ishin të mbyllura me opsione të përshtatura sipas pyetjes së vendosur në pyetësor.

Të dhënat janë analizuar përmes programit statistikor SPSS (version 23). Për analizimin e të dhënave kemi përdorur analizën e frekuencës dhe analizën deskriptive, Crosstable, për të parë ndikimin e ngritjes kualifikuese të mësimdhënësve në performancën e tyre në punë. Përmes analizës u kemi dhënë përgjigje tri pyetjeve hulumtuese. Me përdorimin e teknikave ndërvepruese të mësimdhënies krijohet klima më e përshtatshme për mësimnxënie (67.33%), si dhe me më lehtësi arrihen objektivat e orës mësimore (64.67%). Ngritja në kualifikim ka ndikim më pozitiv në ngritjen e performancës në punë. Sfidat gjatë aplikimit të teknikave ndërvepruese të mësimdhënies janë: Kushtet teknike të klasës (27.3%), Mungesa e materialit didaktik në klasë (22%), Koha e shkurtër në mësimdhënie (18.7%), Mos aftësia për përfshirjen e të gjithë nxënësve në mësimdhënie (14.7%), por ka edhe sfida tjera (17.3%).

**Fjalët kyçe:** *teknika ndërvepruese, klasa gjithëpërfshirëse, kreativitet, mësimdhënie, mësimnxënie*

## **GRANIT NRECAJ**

**Tema: Aplikimi i punës në grupe nga mësime të ndikimit të kësaj forme në aftësitë bashkëpunuese të nxënësve**

### **Komisioni:**

**Prof.asoc.dr.Majlinda Gjelaj, kryetare**

**Prof.asoc.dr. Atdhe Hykolli, anëtar**

**Prof.ass.dr. Vjollca Ahmedi, mentore**

### **ABSTRAKTI**

Ky studim ka të bëjë me aplikimin e punës në grupe nga mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në aftësitë bashkëpunuese të nxënësve. Puna në grupe është formë e përshtatshme e punës sepse ndikon pozitivisht në bashkëpunimin dhe ndërveprimin e nxënësve, zhvillimin e të menduarit, shoqërimin e nxënësve dhe përvetësimin e njohurive. Gjatë veprimtarisë mësimore të nxënësve në grupe nxitet të nxënit, interesimi, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë, shprehjet dhe nxënësit japin mendime, shpjegime, diskutojnë dhe raportojnë për punën e tyre.

Qëllimi i hulumtimit është të identifikojë zbatimin e punës në grupe dhe ndikimin e saj në aftësitë bashkëpunuese të nxënësve. Studimi është realizuar në tri shkolla fillore të komunës së Prishtinës. Pjesë e këtij hulumtimi kanë qenë 15 mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në grupe të shkollave fillore: “Naim Frashëri”, “Pjetër Bogdani”, “Afrim Gashi”. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda sasiore për mbledhjen e të dhënave.

Të dhënat janë mbledhur përmes pyetësorëve me pyetje të mbyllura që kanë qenë të formuluar në bazë të qëllimit të hulumtimit dhe pyetjeve hulumtuese. Analiza e të dhënave statistikore është realizuar me anë të programit SPSS. Sipas rezultateve të këtij studimi del se në klasën e pestë mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në grupe. Rreth 20% e mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në grupe janë pajtuar plotësisht me faktin që punën në grupe e aplikojnë shumë shpesh, poashtu 60% e tyre janë pajtuar me këtë deklaratë. Diku rreth 40% e mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në grupe janë pajtuar plotësisht që forma e punës në grupe përmirëson aftësitë bashkëpunuese të nxënësve. Rreth 80% e mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në grupe pajtohen që kjo formë e punës kontribuon edhe në zhvillimin individual të nxënësit. Kjo dëshmohet edhe me analizën korrelacionale të Pearson-it  $r=0.50$ ,  $p<0.01$  e cila tregon ndërlidhjen pozitive në mes të punës në grupe dhe rritjes së aftësive bashkëpunuese të nxënësve. Edhe ndërlidhja mes entuziazmit për punë me teknikën mësimore që përdoret ka rezultuar pozitive në të dy rastet përmes analizës së Spearman-it që është  $r=0.67$ ,  $p<0.01$ . Për saktësinë e pyetjeve lidhur me hulumtimin e tregon edhe analiza Cronbach's Alpha e cila për mësime të ndikimit të kësaj forme të punës është 0.764 ndërsa për nxënës 0.656 që nënkupton se është e mirë në të dy rastet.

**Fjalët kyçe:** *aktivitete, bashkëpunim, mësime të ndikimit të kësaj forme të punës në grupe, nxënës;*

**MIRLINDA JASIQI**

**Tema: Qëndrimet e mësimit në rreth standardeve të zhvillimit profesional në arsimin parauniversitar në Kosovë**

**Komisioni:**

**Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor**

**Prof. Asoc. Blerim Saqipi, kryetar**

**Prof. As. Vjollca Ahmedi, anëtare**

### **Abstrakti**

Ky studim shqyrton qëndrimet e mësimit në rreth standardeve të profesionit të mësimit në arsimin parauniversitar të Kosovës, shfaq qëndrimet e mësimit për standardet e profesionit të tyre, si dhe identifikon faktorët që ndikojnë në përgatitjen e mësimit për standardet e mësimit dhe zhvillimin profesional të mësimit. Qëndrimet si dhe përvojat e mësimit në këtë studim, paraqesin një bazë të mirë për reformimin e cilësisë së programeve të studimit dhe trajnimeve profesionale. Me anë të tyre, adresohet nevoja që në të ardhmen, përgatitja e mësimit të bëhet krahas standardeve të profesionit të mësimit. Zhvillimi profesional i mësimit ngërthen aktivitetet e zhvillimit profesional në përputhje me kërkesat e sistemit të licensimit dhe me dokumentet tjera që e rregullojnë këtë komponentë, me qëllim të zhvillimit të kompetencave të mësimit që mundësojnë përmirësimin dhe avancimin e praktikave të mësimit dhe nxënies në klasë, në mënyrë që t'u sigurojnë të gjithë nxënësve shërbime arsimore cilësore në përputhje me kërkesat e shoqërisë.

Natyra e hulumtimit është kualitative. Studimi u realizua me anketimin e 300 mësimit; 100 mësimit të Shkollës fillore, 100 të Shkollës së mesme të ulët, 100 të shkollës së mesme të lartë. Instrumenti për mbledhjen e të dhënave është pyetësori me gjithsej 52 pyetje dhe katër pjesë . Të dhënat cilësore u analizuan përmes qasjes së analizës tematike dhe të dhënat sasore përmes SPSS.

Rezultatet e fituara nga ky studim tregojnë se në përgjithësi mësimit i zbatojnë standardet e profesionit të mësimit. Identifikohen saktë cilat janë qëndrimet e mësimit të arsimin parauniversitar të Kosovës në lidhje me zhvillimin profesional të mësimit. Konstatohet në çfarë niveli ekziston zhvillimi profesional i mësimit të arsimin parauniversitar të Kosovës. Analizohet realiteti i praktikave të punës së mësimit në Kosovë, përfshirë sfidat me të cilat ballafaqohen në profesionin e tyre, dhe nivelin e përgatitjes për të ushtruar shkathhtësi të caktuara. Identifikohet modeli i besueshëm dhe i qëndrueshëm i zhvillimit të mësimit në Kosovë, i cili nuk do të jetë i varur nga trajnimet formale.

**Fjalët kyçe:** *Arsim parauniversitar, mësimit, qëndrime, standarde, zhvillim profesional.*

